

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjykata pa avokatë, por me rregullore
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/gjykata-pa-avokate-por-me-rregullore-i588723
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 12:26:34 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 12:25:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	24df5ffff462611db7d705ce654a7fdbbc1287afb2f41a0c414e9a500ff163737b
TEKSTI	6ed2254c63f81a431b2bb9e8f70878a60b2a7cd444d2f7373dac0230b2753ffff
PAMJA	7bfc626c098f80e2bbcbcb04e7cb70956a40c49f5146124527db97d3d4930ed16

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9c1ab14eadc4958617277edc8a6becc1ffe262bfb0e279df7bb3e633edf27988
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	8943aae4786784478314ed8f36e25f0bd32ee36cc85ad3e80ac7b853175904e3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9c1ab14eadc4958617277edc8a6becc1ffe262bfb0e279df7bb3e633edf27988>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

 English

Built and Monetized by 

 English

1 e Gjkata pa avokate, por me rregulloreZjarr ne nje hotel ne qender te Shkodres, nderhyjne tre mjete zjarrheseVizita e Xi Jinping ne SHBA, Wang Yi: Perparim i ri ne marr
fundit

Gjkata pa avokatë, por me rregullore



27 Shtator 2026, 14:25Blog Nga Ylli Manjani

Nga nesër, Gjkata e Posaçme e Shkallës së Parë nuk do të ketë më mundësinë të zhvillojë as seancat për vlerësimin e masave të sigurisë me palët në sallën e gjyqit. Pas një qëndrimi kokëfortë, pa sens juridik dhe pa logjikë institucionale nga drejtuesi i komanduar i kësaj gjykate, Dhoma Kombëtare e Avokatisë ka vendosur përshkallëzimin e reagimit. Asnjë avokat nuk do të marrë pjesë në seancat gjyqësore të masave të sigurisë në atë gjykatë.

Kjo do të thotë konkretisht se, nuk do të ketë avokatë as në seancat ku vendoset për lirinë e një njeriu.

Imagjinoni situatën. Arrestohet një person, apo kapet një i kërkuar. Brenda afatit ligjor ai duhet të dalë para gjykatës për t'u njohur me masën e sigurisë. Gjkata hap seancën... por nuk ka avokat. Sipas ligjit, pa mbrojtës nuk ka proces të rregullt. Atëherë si do ta legjitimojë gjykata kufizimin e lirisë së një qytetari? Përgjigjen, mesa duket, e di vetëm drejtuesi i komanduar dhe rregullorja e tij anti-avokat.

Ndoshta ky nuk ka qenë qëllimi i rregullores. Ndoshta po. Por rezultati është se sot, sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, nuk zhvillohet një gjykim penal pa praninë e avokatit kur mbrojtja është e detyrueshme. Rregullorja nuk mund ta ndryshojë këtë.

E drejta për t'u mbrojtur me avokat nuk është privilegj i avokatëve. Është garancia themelore kushtetuese e procesit të rregullt ligjor. Është një e drejtë e qytetarit përballë shtetit.

Kur një rregullore vendos kushte që e bëjnë të pamundur ushtrimin normal të kësaj të drejte, ajo shumëzohet me zero Kushtetutën. Me atë rregullore gjykata fillon të ngjasojë me kohën e komunizmit, kur avokatura u zhduk si profesion dhe mbrojtja u konsiderua pengesë, jo garanci.

Nëse dikush dëshiron ta ndryshojë rolin e avokatit në procesin penal, duhet ta bëjë me ligj, jo me një akt administrativ. Nuk mund të zëvendësohet ligji me rregullore, as Kushtetuta me gjoba, kërcënime disiplinore apo paralajmërime për ndjekje penale ndaj avokatëve.

Shërbimi i avokatisë nuk rikthehet në sallat e gjyqit me forcë. Rikthehet vetëm kur avokatëve u garantohej të ushtronin profesionin pa parakushte që bien ndesh me ligjin dhe me Kushtetutën.

Sot GJKKO-ja e Shkallës së Parë është, me sa di unë, e vetmja gjykatë në Shqipëri (vështirë të gjendet një tjetër në Europë), ku avokatët pengohen të hyjnë në sallat e gjyqit nga efektivi të Gardës. Një pamje që nuk i shkon një gjykate, aq më pak një gjykatë që pretendon standardet më të larta të shtetit të së drejtës. As gjykatat ushtarake nuk funksionojnë kështu.

Për hir të së vërtetës, kjo rregullore nuk vendos kufizime vetëm për avokatët. Ajo imponon rregulla absurde edhe për gjykatësit dhe prokurorët. Ndryshimi është se ata nuk kanë mundësinë të refuzojnë kolektivisht hyrjen në sallë. Avokatët po.

Prandaj ky vendim nuk është kundër gjyqtarëve dhe as kundër prokurorëve. Është edhe në mbrojtje të atyre gjyqtarëve e prokurorëve që, në heshtje apo hapur, e konsiderojnë këtë rregullore të papranueshme.

Beteja nuk është për një derë gjykate. Është për të drejtën që në atë derë të hyjë ligji përpara rregullores, të hyjë arsyeja përpara kokëfortësisë, të hyjnë njerëz me të drejta civile dhe jo kapëdanë me spaleta ushtarake.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Urrejtja civile](#)

12:55 Blog / 2 komente

[Edhe fundi e ka një erë...](#)

12:40 Blog / 8 komente

["Humori, Parlamenti apo qeveria: Kush të bën të qeshësh më shumë?"](#)

19:30 Blog / 16 komente

[Pse Moody's rrit vlerësimin për ekonominë e Shqipërisë?](#)

17:00 Blog / 1 koment



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.